



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5386 prot.

Himarë, më 11.07. 2025

VENDIM

NR 35 DATË 09.07. 2025
PËR

**“MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË EMERGJENCËS PËR PËRBALLIMIN
E SITUATAVE TË KRIJUARA NGA ZJARRVËNIA NË TERRITORIN E BASHKISË
HIMARË”**

Mbështetur në nenet 34,40,41,45,55 të ligjit nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin 9936 datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29, kreu VII nenet 39-40 të ligjit Nr 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore” ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010. “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave “Mbi procedurat standarde të miratimit të buxhetit”, të ndryshuar, mbi njoftimin për transfertën e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2025, nenit 65, pika 3 të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 08.07.2021 (i ndryshuar me VKM nr. 290, datë 17.05.2023), Këshilli Bashkiak Himarë, në mbledhjen jashtë radhe, zhvilluar në datën 09.07.2025, pasi shqyrtoi projektvendimin dhe relacionin përkatës, e miratoi atë me trembëdhjetë (13) vota pro, një (1) votë kundër dhe një (1) abstenim dhe, si më poshtë,

VENDOSI:

1. Të miratohet përdorimi i fondit të emergjencës të alokuar nga qeverisja qendrore për përballimin e situatave emergjente, të shkaktuara nga zjarret në territorin e Bashkisë Himarë, në përputhje me planin vendor të emergjencave civile dhe dokumentet strategjike të mbrojtjes civile.
2. Fondi do të përdoret:
 - a) për blerjen e automjeteve për përdorim të veçantë në funksion të ndërhyrjes së shpejtë dhe transportit të forcave zjarrfikëse në rast emergjencash (referuar pikës 3.1/ë të VKM-së nr. 414/2021) **10,000,000 (dhjetë milionë) lekë.**
 - b) për blerjen e instrumenteve, mjeteve dhe materialeve operative për përballimin e situatave emergjente dhe mbështetjen e veprimtarisë së strukturave vendore të emergjencës civile (referuar pikës 3.1/g dhe 3.2/a të VKM) **2,986,885.65 (dy milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë lekë e gjashtëdhjetë e pesë qindarka).**

3. Përdorimi i fondeve do të realizohet nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Himarë në përputhje me rregullat e prokurimit publik dhe kontrollit financiar.
4. Ngarkohet drejtoria e financës dhe planifikimit të buxhetit, drejtoria e projekteve dhe integritetit europian, drejtoria e mbrojtjes së territorit dhe mbrojtjes civile për zbatimin e këtij vendimi dhe raportimin e ecurisë së përdorimit të fondeve çdo 4 muaj pranë Ministrisë së Mbrojtjes, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sipas pikës 7 të VKM nr. 414/2021 .

Ky vendim hyn në fuqi sipas legjislacionit përkatës.

KRYETARI
DHIMITËR KAPAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Spiër, Himarë, tel. : 039322355, fax.039322533, [EEE.nimara.gov.al](mailto:info@nimara.gov.al) e-mail: info@nimara.gov.al